




Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060-46332 dt. 09.08 2019

PROCESVERBALI

Lidhur me dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2020-2022

Mbledhjen e hapi z.Bekim Dobra duke filluar në ora 10:00 më 21.06.2019 ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci, kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Labinot Halilaj, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-së, Drejtor të Drejtorive komunale, administrator të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, anëtar të K.P.F.-ca, përfaqësues të KDI-së.

Rend dite:

Për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2020-2022

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit, OJQ-të dhe shoqëria civile, se më datën 21.06.2019 (e premte) duke filluar nga ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit, do të mbahet konsultim publik me qytetar lidhur me:

1. Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB-in) 2020-2022

Korniza Afatmesme Buxhetore është e një rëndësie të veçantë për Komunën e Drenasit, prandaj ju qytetarë të nderuar, shfrytëzoni të drejtën e juaj që të jeni pjesëmarrës aktiv në këtë konsultim publik që është një proces i dëgjimit që do të shërbej për vendimmarrje ku me propozimet dhe vërejtjet e juaja, Ju do të kontribuoni që kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore Komunale të jetë sa më e kompletuar dhe cilësore për të përmirësuar jetën e juaj.

Dëgjimi publik me qytetarë është organizuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Bekim Dobra – I nderuari kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci, Kryesues i Kuvendit të Komunës, z. Labinot Halilaj, drejtor të drejtorive komunale, anëtar të Kuvendit të Komunës, administrator të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, organizatave jo qeveritare, ju qytetarë.

Jemi mbledhur sot ne këtë dëgjim buxhetor për të diskutuar Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022 si dhe Draft-Listën e Investimeve Kapitale për vitet 2020-2022. Ky dokument është përgatitur ne bazë të Qarkores Buxhetore 2020/1 të lëshuar nga Ministri i Financave z. Bedri Hamza dhe paraqet përmbledhjen e kërkesave fillestare të planifikimit e parashikimit për vitin 2020 dhe projeksionit të buxhetit për vitet 2021-2022.

Komuna me kohë ka bërë njoftimin dhe ftesën që nga muaji Maj i këtij viti, pasi që kemi pranuar Qarkoren Buxhetore dhe kemi ftuar ekspertet, OJQ-të, Shoqërinë Civile dhe profesionistët për të kontribuar ne hartimin e këtij dokumenti.

Komuna e Drenasit shquhet për transparencë e llogaridhënie, ndaj me kohë këto dy dokumente, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022 dhe draft-Listën e Investimeve Kapitale i ka publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Ndjej për obligim të ju njoftoj me rregullat e takimit, që diskutimet për buxhet të jenë reciproke me qëllim që të behët një përmbledhje me interes për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit.

Para vetës keni dy materiale, draft-listën e investimeve kapitale si dhe informatën se kah është planifikuar të adresohet buxheti komunal.

Të nderuar të pranishëm, fillimisht i jap fjalën kryetarit të Komunës, z. Ramiz Lladrovci.

Për të elaboruar draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022, ftoj Drejtorin për Buxhet e Financa, z. Shyqiri Bublaku.

Për të elaboruar draft-listën e investimeve kapitale, ftoj drejtorin e Infrastrukturës Lokale, z. Idriz Hysenaj

Të nderuar të pranishëm tani fjala është për ju, por paraprakisht ju kisha lut që kur të merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit të takimit.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci- përshëndeti të gjithë të pranishmit, sot jemi këtu për të dhënë një informatë të shkurtër lidhur me Draft- Kornizën afatmesme buxhetore dhe për të marrë kërkesat e juaja fillestare për investime kapitale, gjithashtu i falënderoj për bashkëpunim të mirë me fshatra dhe kërkoj që të vazhdojmë këtë bashkëpunim edhe me tutje në të mirë të gjithë komunitetit tonë në Drenas. Duke u bazuar në qarkoren 2020/01 e dt. 15.06.2019 ku përcaktohen kufijtë buxhetor për komunat e Kosovës dhe ne si komunë na u kanë përcaktuar kufijtë për vitin 2020 dhe parashikimi për vitin 2021-2022, andaj në vazhdim po i paraqes në vija të trasha kufijtë e përcaktuar për komunën tonë për të tre sektorët. Ky buxhet parashihet nga qarkorja 2020/01, sektori i arsimit është sektori më i madh dhe merr edhe pjesën më të madhe të buxhetit që është 43.39% ose 7,155,716 euro, sektori i shëndetësisë merr pjesë me 12.05% apo shumën me 1,986,270 euro, sektori i administratës merr pjesë në buxhet me 44.56% apo 7.348.306 euro por nga ky sektor mbulohen edhe dy sektor tjerë si ai i arsimit dhe i shëndetësisë për investime kapitale dhe nëse paraqitet e nevojshme edhe për kategoritë tjera. Buxheti i parashikuar për 2020 parashihet të jetë me shumën 16,490,342 euro e nëse e krahasojmë me buxhetin e vitit 2019 shohim se kemi një rritje prej 8,69% e shprehur në euro që paraqet shumen prej 1,318,740 euro që paraqet një rritje solide për prridhen një vjeçare. Ne jemi këtu për t'i marrë kërkesat e juaja dhe për ta shikuar mundësinë e atyre kërkesave që janë më prioritet që janë për vitin 2020 dhe me i fut në prioritet kërkesat tjera që nuk janë më prioritet kërkesat për vitin 2020-2. I falënderoj të gjithë për pjesëmarrje.

Drejtori i Financave- Shyqiri Bublaku, pasi përshëndeti të gjitha. Përgatitja e buxhetit komunal për vitin 2020-2022 ka filluar në mesin e muajit maj dhe kjo është periudha kohore që fillon çdo vit. Duke u bazuar në qarkoren 2020/01 e lëshuar nga MF. Kjo do të jetë qarkorja e parë , sigurisht që do të vinë edhe qarkorja e dytë dhe e tretë në vazhdimësi. Sa i përket buxhetit shohim se korniza afatmesme buxhetore na i ka përcaktuar kufijtë dhe ne nuk mundemi të dalim

nga qarkorja e përcaktua 2020/01. Buxhetin e komunës e përbejnë granditë e qeverisë dhe të hyrat vetanake të komunës dhe kemi grandin specifik për arsim dhe grandin specifik për shëndetësi, tatimi në pronë është në të hyrat vetanake, taksat, ngarkesat dhe gjobat si dhe të hyrat nga pasuria si dhe të hyrat nga palët e treta gjegjësisht donacione që përdoren investime në komunën tonë. Si bazë elementare për caktimin e kufijve buxhetor është numri i popullsisë apo granditë të përgjithshëm siç e quajmë ne administrata e përgjithshme i cili merr 89 %, madhësia gjeografike e komunës e cila merr 6% dhe numri i popullsisë kemi shumë pak 3% dhe komunat, ndërsa të granditë të arsimit trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm dhe merren parasysh këto elemente numri i nxënësve të regjistruar, raporti i nxënësve dhe i mësimdhënësve në arsimin fillor dhe të mesëm, ndërsa të granditë të shëndetësisë si elementi kyç për përcaktimin buxhetor është vizita për kokë banori, shërbimet për kokë banori, koston mesatare për vizitë. Projektioni i të hyrave vetanake për 2020-2022, të hyrat e arkëtuara gjatë viteve paraprake dhe ato të arkëtuara në pjesën e parë të vitit kalendarik. Komuna duke u bazuar në kornizën afatmesme 2020-22 të qeverisë së vendit qarkoren buxhetore 2020/01 të qeverisë së vendit dhe ministrie së financave në analizën e të hyrave nga burimet vetanake planifikon këtë kornizë buxhetore sipas sektorëve kryesor, për sektorin e përgjithshëm të administratës projektioni është 7,351, 548. Euro për vitin 2020, për vitin 2021 7,738,376 euro ndërsa për vitin 2022 janë të planifikuara 8, 171,220 euro. Për sektorin e Arsimit e kemi 7, 152,418. për vitin 2021 është 7, 188,940 dhe për vitin 2022 është 7,225, 675. Sektori i shëndetësisë është 1,986,376 për vitin 2020 ndërsa 2,965,831 për vitin 2021, dhe 2,148,464 për vitin 2022. Gjegjësisht buxheti i komunës për vitet 2020 është 16,490,342 euro ndërsa për vitin 2021 është 16,693,147 euro, ndërsa për vitin 2022 është 17,545,359 euro pra ky është buxheti në bazë të granditë qeveritar. Tabelat e shënuara paraqesin buxhetin sipas viteve dhe sektorëve kryesor, duke u krahasuar me vitin 2019 të dhënat e vitit 2020 janë si projektion ndërsa ato të viteve 2021-22 janë si projektion provues. Nëse e shohim një krahasim të vitit 2019 dhe 2020 buxheti i komunës do jetë në rritje prej 8.69%.

Drejtori i Urbanizmit- Idriz Hysenaj, ju pata jush e keni listën e buxhetit, ka pak ndryshime nga viti i kalua, i vetmi ndryshim rregullimi i shtatit të lumit në tersi thua jse 80-90% do të përfundon, ne edhe vitin e kaluar e kemi pas një buxhet bukur të madh, mirëpo këtë vit e kemi zvogëluar me mundësi që ato pjesë ku kanë mbetur pa u rregulluar. Ne këtë vit jemi të fokusuar që ujërat e zeza t'i përfundojmë në kolektor dhe t'i orientojmë të impianti i ujërave të zeza ku jemi duke bërë përpjekje për ndërtimin saj. Ne këtë vit jemi duke realizuar projektin e pastrimit të lumit. Ndërsa pjesët tjera janë infrastruktura, në shumicën e fshatrave kane mbet vetëm rrugicat, rrugët janë të përfunduara, janë edhe investime tjera që vinë nga drejtoritë tjera, por kryesisht janë këto asfaltime, kanalizime, rrugë, mbikëqyrja e projekteve.

Florim Kiqina-Baicë, pasi shikova këto projekte unë nuk e shikova asnjë projekt për ujë të pijshëm për fshatin Baicë , ne kemi nevojë edhe për shumë gjera tjera mirëpo problemi kryesor është që nuk kemi nevojë për ujë të pijshëm.

Elmi Rexhepi-Shtrubullova, e shikova buxhetin, ne i kemi pas fëmijët në shkollë në Drenas dhe kanë qenë të rrezikuar tek rrethi, kërkojmë ta rregulloni një trotuar këtu nuk e pash në planifikim. Nuk ka nënkalim tek shkolla, trotuar nuk ka, kërkoj ta rregulloni një trotuar, urën me zgjeruar, lumi kur ka te reshura nuk mundemi me dal, një fushe sportive me rregullu.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci- sa i përket çështjes se rrugës tek shkolla në Zabel, obligim e kanë mësimdhënësit, pastruesit e shkollave, tekniket me dal në orar dhe me u kujdes për komunikacionin për me hy dhe me dal nxënësit e tyre. Ne po provojmë më bëmë te mirën për qytetaret tanë.

Nystret Prenku- Dobroshefc, kërkoj që të lidhet rruga nga lagjja "Caraku" deri të lagjja "Fejza" . kërkoj që të vazhdojnë punimet e urës.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci- prioritet e kemi e marrim si kërkesë, unaza ura janë në proces.

Sali Janova- Korreticë e Eperme, sipas informatave që i kam një epjes e asfaltit do të vazhdon në lagjen

"Javnova" po ashtu edhe kanalizimi, por problemi më i madh në lagjen tonë është

çështja e furnizimit me ujë, jemi 45 shtëpi afër 380 banor dhe kemi problem për ujë.

Jahir Beqiri- Drenasi-II, e falënderoj komunën për investimet që i kanë bërë, mirëpo kërkoj një trotuar dhe një çerdhe për fëmijë jemi duke kërkuar që 4 vite dhe ende nuk e kemi

Izet Bytyqi- Fushticë e Naltë, pasi përshëndeti të gjithë, pati dy kërkesa, që nuk janë realizuar viteve të kaluara kanë qenë në buxhet 5 milion vitin 2018 nuk është realizuar as kanalizimi nuk është përfundu ende nuk është realizuar asnjë rrugë që u dashtë me u shtru zhavorr të varrezat.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci- nuk ka asnjë projekt që nuk e kam zhvilluar që ka qenë i votuar ne këtë asamble, nuk ka asnjë projekt që u hekë ose u prish.

Izet Bytyqi, e kemi një lokal të mirë për fushë të sportit për të rinj dhe një çerdhe për fëmijë.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci- në Fushticë është duke u bërë që shkolla më shkollë do të bëhet edhe fusha.

Hajrush Musliu- Shtrubullova, që një vit jemi ne problem me një firmë e cila është duke punuar për tension të lartë që nuk po e kthen gjendje të mëparshme rrugën që vjen për Shtrubullova.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci- inspeksioni i ka marre të gjitha masat e ka dënuar kompaninë e KEDS-it, dhe do t'i kryej punimet dhe pasi t'i kryej punimet do t'i kthej në gjendje të mëparshme.

Imri Bajraktari- Kishnarekë, sa i përket fshatit Kishnarek është punuar por janë disa kërkesa që janë shumë të nevojshme, është kërkesë e fshatit për një trotuar sepse nga shkolla deri ne mes të fshatit nuk kemi e cila është e nevojshme sepse i kemi fëmijët shumë të rrezikuar, propozoj që primare për fshatin tonë të jetë trotuari.

Naser Mulaku- Komoran –III, kërkoj që me vazhdu trotuari edhe ne lagjen tonë, me me prioritet është trotuari për ne.

Afrim Lushaku- L"Feronikeli" si kërkesë e banoreve të lagjes sonë është shtrimi i disa rrugicave në anën e poshtme të rrugës jo lartë dhe aty nuk ekziston as kanalizim as ujësjellës prioritet janë tri rrugica, njëra rrugë e kemi zgjedh çështjen e kanalizimit edhe ujësjellësit.

Fadil Tiku-Verbovc, si kërkesë e jona është fshati Verboc i duhen edhe 5 km asfaltim, i duhen 3000 metra kanalizim, fshati jonë i ka 4 burime me ujë mineral asnjë nuk është rregulluar prej tyre, jemi mirënjohës për investimet që keni bërë deri më tani në fshatin tonë, në lagjen "Zhushi" as nuk është bërë kanalizim as asfaltim, lagjen "Shala" këto janë prioritetet i kemi dhe disa shtëpi tek lagja "Gashi"

Nebi Bajraktari-Drenasi-III, si prioritet për Drenasin –III ka nevojë për investime shumë por prioritet është një lagje e cila është e shtruar në zhavorr ka nevojë për asfaltim kërkesa është bërë, dhe kanalizimi i ujërave të zeza, dhe si kërkesë tjetër është një kabull për me bërë një trase se po kemi probleme me rryme sa herë po bie shi.

Zenel Hyseni-Komoran-I, ne kerkojmë që ne Komoran të bëhet zgjerimi i urbanizimi, si kërkesë e banoreve të Komoranit është rihapja e udhëkryqit të vjetër të Komoranit, kërkesë tjetër e banoreve është ndërtimi i një rreth rrotullimi në rrugën Komoran –Caralevë saktësisht të qendra familjare në Komoran arsyeja komunikacioni i dendur, aksidentet si dhe kolonat e gjata në brendi të Komorani ku këto kolona shkaktojnë probleme sidomos tek shkolla, një kërkesë tjetër është që te jepet tregu i kafshëve me konseksion por nuk është duke e mirëmbajtur mirë, kërkojmë që ne varrezat e Komoranit të bëhet rrethoja e tyre, po ashtu në atë pjesë hedhin mbeturina, gjithashtu edhe rrethoja e shkollës mungon, kërkesë tjetër nga banoret e Komoranit është vendosja e tregut të gjelbër kjo kërkesë është bërë me qëllim që ë mos bllokohet rruga në Komoran. Kërkesë tjetër nga banoret është tek rruga "Anton Qeta" është rregullimi dhe Asfaltimi i kësaj lagje, gjithashtu rruga "Gjeladin Gashi" rrugica e dyte sekondare kërkesa e tyre është rregullimi dhe asfaltimi i lagjes.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci- në Komoran kemi bërë shumë investime, po e bëjmë shkollën profesionale, pishinën gjysme olimpike, stadionin sintetik dhe investime tjera.

Ndriqim Cakiqi-Terstenik- I, ne si kërkesë e fshatit kemi që te përfshihen të gjitha asfaltimet pasi që shumë rrugë janë të pa asfaltuara, mirëpo si prioritet i fshatit tonë për vitin 2020 është asfaltimi i rrugës "Idriz Dvorani" e cila është lënë në gjysmë cila gjatësia e saj është 400 metra, rrugë në lagjen "Gashani" 400 metra asfaltim pasi që rruga nuk është lidhur më asnjë anë dhe ka mbet mesi i lagjes pa asfaltuar, gjithashtu kanë mbet edhe disa rrugë në lagjen "Cakiqi" është 1400 metra këto rrugë kërkoj që vitin e ardhshme të asfaltohen, gjithsej ne fshatin tonë nevojiten 1400 metra asfaltim, problemet e kanalizimit janë përfunduar për atë kërkoj që të rregullohet edhe asfaltimi i rrugëve në Terstenik –I, gjithashtu si kërkesë e fshatit tonë është rinovimi i shkollës gjithashtu shkolla "Zenel Hajdini" ka nevojë që te rregullohet oborri i saj dhe të behët rrethoja e shkollës.

Mergim Shala-Negroc, fshati jonë ka nevojë për kanalizim të ujërave të zeza afërsisht 6010 metra, për asfaltim kemi nevojë për 4310 ku si prioritet është rruga nga trafa tek lagjja "Llokma" në drejtim të Syllisufëve , kurse për trotuar a nevojë mbi 1600 metra ndërsa për trotuar kemi nevojë mbi 1600 metra si prioritet është nga shkolla tek lagjja Llokma, po ashtu kemi nevojë edhe për investime në oborrin e shkollës nuk ka fushë sportive të mirë, kemi nevojë për ujësjellës asnjë shtëpi nuk ka ujësjellës ne fshatin Negroc po ashtu edhe për ndriçim.

Murat Elshani-Gllobar, si prioritet kryesor në fshatin Gllobar është trotuari për arsye se janë tri km se 90 % e nxënësve kalojnë asajde, kanalizimi i ujërave të zeza kanë mbet edhe disa familje të cilat nuk janë të kyçura në kanalizim, e kemi bërë edhe një kërkesë për një fushë sportive.

Kadri Ajazi- Sankovc, ne si përfaqësues të fshatit si kërkesë e banoreve është kanalizimi i ujërave të zeza pa u përfundu, kërkesë tjetër është asfaltimi i rrugëve dhe i rrugicave në lagje, gjithashtu trotuari është shumë më rendësi rruga që dërgon për shkollë të behet trotuar ajo pjesë sepse është rrezik për fëmijët, kërkojmë 3 kabina strehuese, ndriçimi edhe në fshatin tonë.

Enver Hoxha- Damanek, ne i kemi tri kërkesa për fshatin tonë, të behët vazhdimi i trotuarit në Damanek, ujë nuk kemi sepse sipas analizave na ka dal uji jo i pijshëm, dhe ndriçimi.

Fadil Smajli- Fushticë e Eperme, kërkesat që i kemi bërë ne vitin 2018 prapë të njëjtat kërkesa po duhet me i bë sepse nuk janë realizuar, rruga në drejtim të varrezave është shumë e nevojshme për fshatin tonë

Rexhep Morina, si prioritet në fshatin tonë është kanalizimi i ujërave të zeza në dy lagje rreth 500 metra gjatësi, gjithashtu edhe ujësjellësi është i përfunduar po nuk po kemi mundësi me riaktivizuar nëse ka mundësi me leshu ujin, që një vit është i përfunduar projekti por nuk ka ujë.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci- do të shohim pse nuk është funksional uji .


Ramadan Rama- Terdevc, si kërkesë për fshatin tonë është kanalizimi i ujërave të zeza dhe dihet që gropa septike nuk e përballon kanalizimin dhe është emergjente që kanalizimi të kryhet.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci,

Bekim Dobra- falënderoj të gjithë të pranishmit për pjesëmarrje.

Takimi përfundoi në ora: 11:50 min

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi

